

PROÇESVERBAL I MBLEDHJES DATËS 30 MARS 2026

Kryesuesi I mbledhjes është: Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi

Ora e hapjes së mbledhjes: 10:00

Zhvillimi i mbledhjes: Në sallën e Këshillit Bashkiak

Këshilltarë pjesëmarrës në momentin e hapjes së mbledhjes: 22

Sekretari i Këshillit deklaroi kourumin prej këshilltarësh: 22

Të pranishëm nga administrata e Bashkisë: Drejtorë të Administratës.

Të pranishëm në mbledhje qytetarë: 0

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Mirëmengjesi të gjithëve ashtu si u njoftuat ditën e enjte po zhvillojmë këtë mbledhje jashtërradhe të Këshillit Bashkiak me kërkesë të kryetarit të Bashkisë për miratimin e dy materialeve që u diskutuan mbledhjen e kaluar por nuk morën numrin e nevojshëm të votave për ta miratuar. Kryetari e ka thirrur edhe njëherë mbledhjen ndaj jeni këtu sot. Ju lutem këshilltarëve të miratojnë rendin e ditës, i cili është shpërndarë. Kush është dakort me rendin e ditës?

Pika 1 e rendit të ditës.

PËR MIRATIMIN E RENDIT TË DITËS.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 22 këshilltarë, 22 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 2 e rendit të ditës.

“ PËR MIRATIMIN E TAVANEVE PËRGATITORE TË SHPENZIMEVE TË PROGRAMIT BUXHETOR AFATMESËM 2027-2029 NË NIVEL PROGRAMI.”

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Ky material u paraqit edhe nga komisioni. Ka dikush nga këshilltarët për të shtuar diçka, apo e quani të ezaruar diskutimin e bërë mbledhjen e kaluar?

Nëse nuk ka diçka tjetër, hap procesin votimit.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 22 këshilltarë, 22 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Pika 3 e rendit të ditës.

“ PËR MIRATIMIN E PËRDORIMIT TË FONDIT PREJ 2,615,046 LEKË PËR BLERJE KARBURANTI PËR EMERGJENCAT CIVILE.”

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Edhe ky material u paraqit edhe nga komisioni, u diskutua nga këshilltarët. Ka dikush nga këshilltarët që do thotë diçka?

Këshilltar P.Tollkuçi: Përshëndetje kryetare, këto dy materiale u diskutuan edhe mbledhjen e kaluar të 2-ja janë detyrime ligjore. Miratimi i tavanëve është detyrim ligjor dhe duhet miratuar që mbledhjen e kaluar por dhe miratimi i fondit të emergjencave sigursht që duhet miratuar për arsye sepse ka të bëjë me investime konkrete në teritorin e Bashkisë. Gjithsesi ne sot po shohim mungesën e opozitës dhe vumë re mungesën e votës të tyre, të dy materialeve mbledhjen e kaluar. Por vëmë re edhe mungesën e opozitës këtu, ne nuk jemi për ngecjen e qytetit dhe punëve të tij, ne jemi për mbarëvajtjen e çdo punëve dhe të jemi afër qytetarëve kjo është politika jonë dhe jo ambandonimi dhe e kundërshtimi të çdo materiali me votë kundër dhe ambandonimit vetëm në emër të politikës. Ju ftoj këshilltarët të votojnë edhe këtë pikë sikurse pikën tjetër dhe ju falenderoj për pjesëmarrjen.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Nëse nuk ka diçka tjetër, hap procesin votimit.

Hidhet në votim dhe miratohet

Vota PRO 22

Vota KUNDËR 0

Vota ABSTENIM 0

Sekretari i Këshillit E.Naçi: Janë 22 këshilltarë, 22 pro, 0 kundër, 0 abstenim.

Kryetari i Këshillit Bashkiak Ana Verushi: Faleminderit këshilltarëve për prezencën. Suksese ekzekutivit, mirë u takofshim mbledhjen e radhës!

SEKRETARE E KËSHILLIT EVA NAÇI

KRYETARE E KËSHILLIT BASHKIAK ANA VERUSHI